

## Detyrat e shtëpisë - fletë informimi për prindërit me fëmijët në shkollën fillore

Detyrat e shtëpisë janë me traditë të gjatë në shkollat zvicerane. Me detyrat e shtëpisë, mësimet e shkollës përsëriten duke ju hyrë thellë në brendësi. Fëmijët mësojnë ti kryejnë disa detyra përkatëse në mënyrë të pavarur. Në të njejtën kohë juve si prindër keni mundësi të njiheni me punët që bëjnë fëmijët në shkollë.

Detyrat e shtëpisë janë të detyrueshme, dhe fëmijët duhen ti bëjnë ato. Prindërit duhen siguruar, që ato detyra bëhen. Për këtë shkollat afrojnë përkrahje.

### Si mund të mësojë fëmija juaj më mirë?

- **Vendi i punës:** Vendi duhet të jetë i qetë dhe i rregullt. Librat dhe lapsat të jenë gati. Televizori dhe telefoni celular të fikur.
- **Kohët e rregullta për mësim:** kohët për mësim duhen planifikuar qartë në përditëshmëri, p.sh. pas pushimit të orës katër.
- **Televizori, lojërat në kompjuter, telefoni celular:** nuk duhen përdorur menjëherë para ose pas detyrave të shtëpisë (prisni 30 minuta). Trurit i duhet kohë, për të fiksuar /memorizuar gjërat e mësuara.
- Lëvizjet, një ushqim i shëndetshëm dhe pushimet ndihmojnë për të mësuar me sukses.

Përsëritjet janë të rëndësishme për të fiksuar ato që është mësuar. Përsëritja e saktë bëhet:

- pas 20 minutash
- në të njëjten ditë
- pas një dite
- pas tre diteve
- pas një jave
- pas një muaji

### Këshillat për një mësim të pavarur

Fëmijët sipas personalitetit dhe moshës mësojnë ndryshe nga njeri-tjetri. Njeri ka nevojë për më shumë përkrahje nga prindërit, tjetri për më pak. Fëmijëve me probleme në mësim ju duhet një përkrahje e veçantë.

### Prindërit kështu mund të ndihmojnë

- Tregoni interes për detyrat e shtëpisë. Lini fëmijën tuaj që t'ju shpjegojë detyrat. Mos bëni shumë pyetjet menjëherë. Jepni kohë fëmijës tuaj për t'u përgjigjur pyetjeve.
- Të jeni të gatshëm për fëmijën tuaj. Ndihmoni vetëm kur fëmija juaj ju kërkon ndihmë.
- Mos ulni drejtpërdrejtë pranë fëmijës tuaj.
- Fëmija juaj duhet ti bëjë vet detyrat.
- Kontrolloni detyrat vetëm, në qoftë se fëmija juaj ju pyet.
- A nuk ka kuptuar mirë detyrat fëmija juaj? Çfarë është qëllimi i saktë? Çfarë duhet të dijë fëmija juaj?
- **Mjete përkrahjeje:** Çfarë llojë dokumentash i duhen fëmijës tuaj për të zgjidhur detyrat? Çfarë mjete dhe dokumenta duhen organizuar akoma?

Në qoftë se fëmija juaj nuk mund ti zgjidhë vet detyrat e shtëpisë, dërgoni fëmijën me pyetjet e tij te mësuesja/mësuesi. Në qoftë se është e nevojshme lajmëroni mësuesen/mësuesin (me telefon, me libesën e kontaktit, me email ose me një letër të shkurtër)

- **Planifikim:** Jepni udhëzime, si mundet fëmija juaj të **organizojë vetën më mirë** dhe si arrin qëllimin më thjesht. Kërkoni fëmijës tuaj që të bëjë një listë të detyrave të shtëpisë. Ndhmoni fëmijën tuaj të planifikojë në cilën radhë dhe në çfarë momentin duhen bërë detyrat e shtëpisë. në qoftë se është e nevojshme përkrahni fëmijën tuaj për të radhitur detyrat e shtëpisë sipas afatit të dorëzimit. **Mësimet për provimet duhen kohë për të përsëritur: filloni në kohë!**
- **Kush mundet të ndihmojë:** A munden vëllezërit/montrat më të mëdhej të ndihmojnë për detyrat e shtëpisë? Shfrytëzoni ofertat e shkollës si ndihmë dhe kujdesje për detyrat. Në qoftë se nuk e përballon dot , atëherë kontaktoni mësuesen/mësuesin e fëmijës tuaj.

### Shkolla është e rëndësishme! Tregoni këtë me interesin tuaj.

- Tregoni **interes** për atë, që bën fëmija juaj për shkollën.
- Të jeni të gatshëm për fëmijën tuaj.
- Tregoni **kënaqësi** kur fëmija juaj ka arritje në diçka.
- **Inkurajoni** fëmijën tuaj që të vazhdojë punën dhe mos të heqi dorë, në qoftë se nuk mëson diçka me herë të parë.
- **Ngushëlloni** fëmijën tuaj në humbje dhe jepni kurajo për herën tjetër.
- **Lavdëroni** fëmijën tuaj më shumë për kontributin në punë, sesa për notat ose rezultatet.

### Ruajini kontaktet me mësueset/mësuesët e fëmijës tuaj.

Shfrytëzoni kontaktet me mësuesen/mësuesin e fëmijës tuaj. Vetëm një kontakt i shkurtër krijon besim.

- **Telefon:** telefononi në shkollë para ose pas orës së mësimt.
- **Libresë e kontaktit, letër, shënim:** Shkruani mësueses/mësuesit së/e fëmijës tuaj, kur keni një lutje. Kërkoni një bisedë.
- **Ditët e vizitave:** Shkoni në shkollë dhe shfrytëzoni mundësinë për të përjetuar dhe kuptuar mësimin e fëmijës tuaj.
- **Mbledhjet e prindërve:** Merrni pjesë në mbledhjet e prindërve dhe tregoni interesin tuaj.
- **Takim:** Lini takim me mësuesen/mësuesin për të biseduar me qetësi për përparimet e fëmijës tuaj dhe për kërkesat tuaja.

### Informacionet e mëtejshme:

[www.elternwissen.ch](http://www.elternwissen.ch), [www.sveo.ch](http://www.sveo.ch), [www.schule-elternhaus.ch](http://www.schule-elternhaus.ch)



Filmat nga Fabian Grolimund për temat mësim, motivim. „Hausaufgaben“ në YouTube dhe [www.fritzundfraenzi.ch](http://www.fritzundfraenzi.ch)

Kjo fletë informimi është përkthyer në dymbëdhjetë gjuhë dhe mund të shkarkohet (download) në faqën e internetit: [www.elternwissen.ch/hausaufgaben](http://www.elternwissen.ch/hausaufgaben). Është përgatitur në bashkëpunimin me:

Schule und Elternhaus  
Schweiz



Shtator 2013